

INFEKSIONET SPITALORE

1. Cila nga të mëposhtmet konsiderohen si masa më efikase për parandalimin e infeksioneve spitalore:

- a) Antibiotiko - profilaksia.
- b) Kontrolli mikrobiologjik i ambientit të punës.
- c) Larja e duarve.

2. Një infeksion spitalor është:

- a) Një infeksion që duket ne momentin e shtrimit.
- b) Një infeksion që lind në spital.
- c) Një infeksion në inkubacion gjatë shtrimit në spital.

3. Sëmundje infektive quhet ajo sëmundje që tregon:

- a) Praninë e mikroorganizmave në trupin e njeriut.
- b) Një aksident që pëson njeriu.
- c) Një gjendje emocionale e njeriut.

4. Kontaminimi është:

- a) Prania e mikrobeve patogjene në materiale jo të gjalla.
- b) Prania e mikrobeve patogjene në trupin e njeriut.
- c) Prania e mikrobeve patogjene në ambientin ku ne jetojmë.

5. Infeksionet nozokomiale shkaktohen nga:

- a) Mosrespektimi i rregullave në spitale .
- b) Mosrespektimi i higjenës gjatë dhënies së kujdesjeve.
- c) Gjatë komunikimit me pacientin pa vendosjen e një maske.

6. Kriter për shfaqjen e një infeksioni nozokomial është kur temperatura:

- a) Që paraqet pacienti shfaqet që nga dita e shtrimit në spital.
- b) Që shfaqet në ditën e tretë.
- c) Që shfaqet ne ditën e shtate.

7. Ku është rreziku më i madh për shfaqjen e infeksioneve spitalore në:

- a) Kirurgji.

- b) Reception.
- c) Shërbime të tjera.

8. Infeksionet kirurgjikale më të shpeshta janë në :

- a) Plagët kirurgjikale.
- b) Traktin respirator.
- c) Traktin urinar.

9. Sa ditë duhet të mbahet kateteri periferik:

- a) 3 ditë.
- b) 7 ditë.
- c) 10 ditë.

10. Sa ditë duhet të mbahet një kateter urinar:

- a) 3 ditë.
- b) 7ditë.
- c) 10-12 ditë.

11.Larja e duarve është e papranueshme kur realizohet me :

- a) Sapun dhe ujë të rrjedhshëm.
- b) Me dezinfektant.
- c) Vetëm me ujë të rrjedhshëm.

12.Pacienti i hospitalizuar manifeston flebit në vendin e katerit venoz. Infermieri duhet menjëherë të:

- a) Heq katerin, vendos kompresa të ftohta në vendin e flebitit, vendos një tjetër kateter në një vend tjetër.
- b) Provon nëse rruga është e hapur me një shiringë me sol fiziologjik dhe më pas vendos kompresa me alkool mbi vendin e flebitit dhe vazhdon mjekimin e rradhës.
- c) Vazhdon mjekimin e rradhës duke e konsideruar normale.

13.Sa shpesh duhen larë duart gjatë një turni.

- a) Sa herë që kryejmë veprimet të pacienti.
- b) Sa herë ndërrojmë pacientin.
- c) Para dhe pas higjenës së pacientit.
- d) Sa herë kryejmë të gjitha këto që thamë më lart.

14. Një flakon me solucione glukozë ose fiziologjik të cilën ne e përdorim për të holluar medikamente që do të aplikohen i/venoz, sa është afati që ky flakon duhet ruajtur në infirmieri që nga momenti i fillimit:

- a) 1 orë.
- b) 10 orë.
- c) 24 orë.
- d) 48 orë.

15. Një flakon me antibiotik të cilit i kemi marrë një dozë dhe na mbetet një dozë tjetër në këtë flakon, cili është afati që ky flakon duhet ruajtur në infirmieri.

- a) 1 orë.
- b) 2 orë.
- c) 12 orë.
- d) 3 ditë.

16. Një ampule pasi i kemi marrë një sasi të përbërësit, një pjesë tjetër ne e ruajmë ku:

- a) Në po atë ampulë duke e mbuluar me një copë pambuk.
- b) Në një shiringë të pastër.
- c) Në një shiringë të pastër duke shënuar orën dhe datën e fillimit.
- d) Në një shiringë të pastër duke shënuar orën dhe datën e fillimit dhe emrin e medikamentit.

17. Pasi kemi vendosur një kateter venoz a duhet shënuar ora dhe data e vendosjes?

- a) Po.
- b) Jo.
- c) S'ka rëndësi data dhe ora.

18. Gjatë vendosjes së një kateteri urinar cila nga këto veprime nuk është e nevojshme?

- a) Dezinfektimi i zonës me betadinë.
- b) Veshja e dorezave sterile.
- c) Aplikimi i një qetësuesi i/venoz.
- d) Lyerja e kateterit me lubrifikant.
- e) Mbushja e ballonit me 5-10 ml sol fiziologjik.

19. Një flakon përpara se t'a aplikojmë i/venoze, cilat nga këto veprime janë të nevojshëm për parandalimin e infeksioneve spitalore?

- a) Kontrolli i datës dhe skadencës.
- b) Kontrolli i papastërtive dhe i turbullirave të përbërjes së flakonit.
- c) Sasia e flakonit.
- d) Përshkrimi i mjekut.